

URDHËR
Nr. 617, datë 5.6.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË DERMATOZËS
NODULARE TË GJEDHIT (*LUMPY SKIN DISEASE*), NË SHTETIN E FRANCËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) të gjitha kafshëve të gjalla të llojit gjedh dhe buajve të ujit;
- b) qumështit të papasterizuar, ku nuk është arritur shkatërrimi i virusit dhe që nuk janë marrë masat e nevojshme paraprake pas përpunimit të tij për të shmangur kontaktin e qumështit me çdo burim të mundshëm të virusit të dermatozës nodulare të gjedhit;
- c) spermës dhe embrioneve të kafshëve të llojit gjedh dhe të buajve të ujit;
- ç) miellit të mishit, miellit të gjakut, mishit të ndryshëm nga mishi i muskujve skeletorë ose kocka nga kafshët e llojit gjedh dhe nga buajt e ujit;
- d) lëkurës së patrajtuar ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit dhe që nuk janë marrë masat e nevojshme paraprake pas përpunimit të tij për të shmangur kontaktin e lëkurëve të patrajtura me çdo burim të mundshëm të virusit të dermatozës nodulare të gjedhit.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e dermatozës nodulare të gjedhit (*lumpy skin disease*), të shfaqur në shtetin e Francës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Haute-Garonne	-	Saint-Gaudens
2.	Ariège*	-	-
3.	Pyrénées-Orientales	-	Céret*
4.	Aude	-	Limoux*
5.	Pyrénées-Orientales	-	Prades*
6.	Hautes-Pyrénées	-	Tarbes*
7.	Ariège	-	Pamiers
8.	Doubs	-	Besançon*
9.	Ain	-	Bourg-en-Bresse*
10.	Jura	-	Dole*
11.	Rhône	-	Lyon*
12.	Ain	-	Nantua*
13.	Ain	-	Belley*
14.	Haute-Savoie	-	Annecy*
15.	Savoie	-	Chambéry*
16.	Savoie	-	Albertville*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të llojit të llojit gjedh dhe të buajve të ujit, qumështit, spermës dhe embrioneve të kafshëve të llojit gjedh dhe të buajve të ujit, miellit të mishit, miellit të gjakut, mishit të ndryshëm nga mishi i muskujve skeletorë ose kocka dhe lëkurëve të patrajtura të kafshëve të llojit gjedh dhe të buajve të ujit, për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit gjedh dhe buajve të ujit, qumështit, spermës dhe embrioneve të kafshëve të llojit gjedh dhe të buajve të ujit, miellit të mishit, miellit të gjakut, mishit të

ndryshëm nga mishi i muskujve skeletorë ose kocka dhe lëkurëve të patrajuara të kafshëve të llojit gjedh dhe të buajve të ujit.

6. Urdhri nr. 646, datë 3.7.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së dermtozës nodulare të gjedhit (*lumpy skin disease*), të shfaqur në shtetin e Francës”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri